



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.23

Prishtinë, më 29.07.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Mungoi: Srdjan Popović

Pjesëmarrës të tjerë: Blendina Krasniqi-UNDP (praktikante), Luan Kryeziu-UAFK Sekretar i përgjithshëm, Blerta Zeqiri-regjisore, Shkumbin Istrefi-aktor, Nehat Dervishi-OSCE, Fjolla Uka-KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 24.07.2015.
3. Diskutim lidhur me Udhëzimin Administrativ MASHT nr.06/2015 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. Të ftuar përfaqësuesit e MASHT;
4. Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë për Propozimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-050 për Kinematografinë, para miratimit në parim;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.07.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.07.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me Udhëzimin Administrativ MASHT nr.06/2015 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. Të ftuar përfaqësuesit e MASHT

Nait Hasani, tha se për shkak të mungesës së ministrit kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet.

Ismajl Kurteshi, tha se përkundër asaj që ministri ka diskutuar në Kuvend për këtë çështje, ftesa e Komisionit ka qenë valide dhe Komisioni nuk ka ardh në përfundim që pas fjalës së tij në seancë të mos jetë prezent në mbledhje. Ai theksoi se mos ardhja është papërgjegjësisë ndaj Komisionit dhe nuk arsyetohet me debatin në Kuvend.

Shukrije Bytyqi, tha se po kemi ndryshime të shpeshta të udhëzimeve administrative dhe ky udhëzim administrativ që është nxjerr është komplet politik prandaj do të ishte shumë e nevojshme që ministri të jetë prezent sot për të diskutuar këtë çështje.

Bekim Haxhiu, tha se për shkak të disa çështjeve që duhet të konsultohemi me ministrin nuk kemi nevojë ta trajtojmë këtë pikë të rendit të ditës pa prezencën e tij. Ai theksoi se ne duhet të kemi një ligj i cili e rregullon zgjedhjen e mësimdhënësve në shkollimin e ulët dhe parauniversitar dhe zgjedhjen e drejtorëve dhe inspektorëve të arsimit me qëllim që ti largojmë ndikimet politike në sferën e arsimit.

Salih Morina, tha se ne duhet të diskutojmë sa i përket këtij udhëzimi administrativ që e ka nxjerr ministri dhe të marrim sqarime se a ka pësuar ndryshime, të paktën të informohet kryetari i Komisionit dhe përmes tij edhe ne.

Shpejtim Bulliqi, tha se ministri na ka ftuar në takim për të diskutuar rreth këtij udhëzimi administrativ dhe ka marr për obligim që vërejtjet dhe sugjerimet tona rreth tij ti inkorporoj.

4. Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë për Propozimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës

Nait Hasani, tha se ministri përmes Qeverisë e ka propozuar listën me anëtarë për formimin e Këshillit Kombëtar të Shkencës. Ai theksoi se lista nuk është e plotë dhe nuk janë të përfshirë përfaqësues nga fushat prioritare prandaj këtë listë duhet t'ia kthejmë ministrit që ta plotësoj dhe përmirësoj.

Mufera Sinik, pyeti se cili nga përfaqësuesit në këtë listë është boshnjak.

Bekim Haxhiu, tha se numri i anëtarëve në këtë listë nuk është i plotë edhe procedura e propozimit të anëtarëve nuk është bërë konform ligjit. Ai theksoi se do të duhej të sugjerohej Ministria që para se ti sjell emrat për Kuvend të mos propozoj anëtarë që kanë angazhime të mëdha për arsye se këta kandidat do të merren me shkencë dhe do ti vlerësojnë projektet e atyre që do të merren me shkencë.

Shpejtim Bulliqi, tha se në këtë Këshill prej periudhës së pas luftës janë kandidatët e njëjtë dhe Kosova ka edhe shumë emrat të tjerë që kanë vullnetin dhe dëshirën për këtë punë dhe që janë shumë më të lirë se këta anëtarë të propozuar. Ai theksoi se duhet të kërkojmë nga ministri që të përcjell këtë listë tek njësitë akademike dhe të jenë njësitë akademike ato që e japin fjalën se cilët janë kandidatët e gatshëm të kontribuojnë dhe lista me kandidatët e propozuar nga ana e tyre të vie tek ne.

Ismajl Kurteshi, tha se sa i përket propozimeve për Këshill Kombëtar të Shkencës ne duhet ti kemi të njohura procedurat e përzgjedhjes dhe duhet që të propozuarit të jenë nga bota e shkencës dhe jo nga politika sepse Qeveria nuk është kompetente të bëjë përzgjedhje mirëpo nëse Qeveria i merr propozimet e botës së shkencës atëherë do të dalin njerëz që mund të kontribuojnë në këtë Këshill.

Teuta Haxhiu, tha se është e paarsyeshme mos zgjedhja e anëtarëve të Këshillit që sa vite. Ajo theksoi se nëse këta anëtar kanë angazhime dhe nuk mund të jenë të denjë për këtë Këshill atëherë duhet të zgjidhen anëtar të tjerë sepse kemi emra që mund të jenë pjesë e kësaj liste.

Salih Morina, tha se ne duhet të sugjerojmë ministrin që ta ketë parasysh nëse emrat e propozuar janë të përfshirë në çështje politike.

Nait Hasani, tha se në këtë listë nuk e miratojmë me arsyetimin se nuk është e plotë, lista nuk siguron përfaqësimin adekuat të Institucioneve kërkimore-shkencore, dhe anëtarët nuk janë të propozuar nga institucionet shkencore.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-050 për Kinematografinë, para miratimit në parim

Nait Hasani, tha se Projektligji për Kinematografinë ka ardhur në Kuvend dhe i ka plotësuar kushtet për shqyrtim në parim. Ai theksoi se Projektligji është i mirë mirëpo me disa vërejtje që mund të përmirësohen duke i marrë parasysh propozimet për ndryshim nga të gjithë akterët e përfshirë gjatë dëgjimeve publike.

Salih Morina, tha se do të ishte mirë sidomos në ligjet që janë të rëndësishme të jenë prezent përfaqësues nga zyra ligjore sepse Komiteti i Artistëve nga komentet që i kanë dhënë janë bazuar kryesisht në kriteret dhe standardet e BE-së. Ai theksoi se në parim e mbështesim këtë projektligj dhe janë të mirëseardhura propozimet për plotësim-ndryshime me qëllim që të krijojmë një ligj sa më cilësor dhe të përshtatshëm.

Teuta Haxhiu, tha se propozimet e juaja do ti kemi parasysh sepse janë më profesional dhe kërkoi që Komiteti i Artistëve të jetë i një zëri në mënyrë që mos të dalin probleme më vonë. Ajo tha se në parim e mbështes këtë Projektligj për të vazhduar me procedurat e mëtejme dhe ne si Komision do të japim kontributin tonë.

Shkumbin Istrefi, falënderon për përkushtimin e Komisionit, ai theksoi se ne përfaqësojmë një grup prej 30 punëtorëve profesionist në kinematografi me të cilët kemi diskutuar ligjin, kemi propozuar vërejtjet tona në debatin publik të organizuar nga Ministria e Kulturës, shumica e të cilave janë të përfshira në këtë Projektligj. Ai theksoi se në parim e përkrahim këtë Projektligj dhe derisa të aprovohet ne do të japim kontributin tonë për avancimin e tij.

Nait Hasani, tha se projektligji i plotëson kushtet për tu përkrahur në parim, ai theksoi se ne do të organizojmë debate publike ku ju mund ti sillni propozimet për ndryshime.

5. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi, pyeti se a i është propozuar kryesisë që ta fus në rend të ditës raportin e Këshillit për Trashëgimi Kulturor.

Nait Hasani, tha se Komisioni e ka përcjelluar propozimin dhe është çështje e kryesisë se kur do të hy kjo pikë në rend të ditës.

Bekim Haxhiu, tha se edhe në mandatin e kaluar e kam parashtruar problemin e çantave shkollore të ngarkuara të nxënësve, e cila po rezulton me pasoja për shëndetin e tyre, ku rreth 40% e fëmijëve vuajnë nga deformimet e shtyllës kurrizore. Ai theksoi se duhet ti dërgojmë Ministrisë një shkresë që të na informoj se ku janë me procesin e reduktimit të peshës së çantave shkollore dhe evitimin e dëmtimeve të fëmijët.

Nait Hasani, tha se kam biseduar me ministrin për këtë çështje dhe procesi i realizimit të projektit për pajisje me rafte nëpër shkolla është duke u realizuar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani